

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 07/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 14 tetor 2006 – 31 dhjetor 2006

Titujt kryesor

- **Ministri i Shëndetësisë i drejtohet Kuvendit në përgjigje ndaj mocionit për interpelancë të parashtruar nga ORA**
- **Kuvendi miraton deklaratën me të cilën dënon mbajtjen e referendumit për Kushtetutën e Serbisë në Kosovë**
- **Kuvendi debaton për raportin e Auditorit të Përgjithshëm mbi të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës dhe formon një Komision Hetues ad hoc**
- **Kryesia heziton ta pranojë propozimin lidhur me përfaqësimin e z. Bislim Hoti në Kryesi**
- **Kuvendi voton për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij por vlefshmëria e votimit vëhet në dyshim**
- **Kuvendi miraton buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2007**

Raporti i dyzetënëntë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur gjashtë seanca plenare të rregullta, më 19-20 tetor, 27 tetor/3 nëntor, 16/17/20 nëntor, 30 nëntor, 14/18 dhjetor dhe 20-23 dhjetor si dhe gjashtë mbledhje të Kryesisë, më 16 tetor, 2 nëntor, 9 nëntor, 24 nëntor, 11 dhjetor dhe 18 dhjetor. Dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike i kanë mbajtur mbledhjet gjatë periudhës raportuese.¹ Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 28 prej 52 mbledhjeve të komisioneve, një mbledhje të nënkomisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, të gjitha mbledhjet e komisionit hetues dhe dy dëgjime publike.²

¹ Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 16 dhe 24 tetor, 8, 21, 23 dhe 29 nëntor, 5 dhe 13 dhjetor derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është takuar më 16, 24 dhe 26 tetor, 1, 13, 20 dhe 24 nëntor. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 25 tetor, 6 nëntor, 4 dhe 19 dhjetor derisa Komisioni për siguri është takuar më 17 tetor, 22 nëntor dhe 13 dhjetor. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 19 tetor, 1 dhe 7 nëntor, dhe 19 dhjetor derisa Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenia sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 31 tetor, 7 nëntor, dhe 5, 12 dhe 19 dhjetor. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 16 dhe 25 tetor, 7, 10, 14 dhe 28 nëntor, 5, 12 dhe 26 dhjetor derisa komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 17, 25 dhe 31 tetor, 7, 13, 21 dhe 29 nëntor, dhe 5 dhjetor. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 17 tetor, 20 nëntor dhe 19 dhjetor derisa Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 9 nëntor. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 18 tetor, 8 dhe 22 nëntor dhe 13 dhjetor. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2004/8 për energji më 20 tetor, dhe për projektligjin për ndryshimin e ligjit Nr. 2004/9 për rregullatorin e energjisë. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur dëgjimin publik mbi zbatimin e ligjit 2002/2 për arsimimin fillor dhe të mesëm më 29 nëntor. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë më 5 dhjetor.

² Komisioni për buxhet dhe financa më 16 dhe 24 tetor, 8, 21, 23 dhe 29 nëntor, 5 dhe 13 dhjetor; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve më 16, 24 dhe 26 tetor, 1, 13, 20 dhe nëntor; Komisioni për çështje gjyqësore,

1. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 19-20 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtar i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e gjashtë dhe 66 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 19, përkatësisht 20 tetorit.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 19-20 tetorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Debat i për situatën e sigurisë në Kosovë (Ministri i punëve të brendshme Fatmir Rexhepi ka dhënë deklaratë, që është pasuar nga shefat e grupeve parlamentare, debat plenar dhe është mbyllur me deklaratë përfundimtare të Ministrin Rexhepi.)
 - Mocioni për interpelancë për Ministrin e Shëndetësisë parashtruar nga ORA (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Interpelanca”.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar (Projektligji është miratuar në parim me 33 vota për dhe 28 vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 27 tetor/3 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtar i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Shtatëdhjetë e pesë dhe 88 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 27 tetorit, përkatësisht 3 nëntorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27 tetorit/3 nëntorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i raportit të Auditorit të përgjithshëm për të gjeturat faktike në Kuvend për vitet 2004-2005 (Të gjithë shefat e grupeve parlamentare kanë dhënë deklaratë, ku janë pasuar me debat plenar dhe miratim të propozimit për formimin e një Komisioni Hetimor ad hoc. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Formimi i Komisionit Hetimor ad hoc”.)
 - Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Rregullatore të Telekomunikacionit për vitin 2005 (Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 16, 17 dhe 20 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtar i Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

- Tetëdhjetë e tetë, 81 dhe 79 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 16, 17 përkatësisht 20 nëntorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 16, 17 dhe 20 nëntorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për auditimin e brendshëm (Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për transformimin e poseduesve të pronës private në pronarë (Projektligji është miratuar në parim me 73 vota për dhe dy vota kundër.)

legjislative dhe Kornizë Kushtetuese më 25 tetor, 6 nëntor, dhe 19 dhjetor; Komisioni për siguri më 17 tetor dhe 22 nëntor; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 1 dhe 19 dhjetor; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur më 31 tetor, 12 dhe 19 dhjetor; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 16 tetor dhe 12 dhjetor; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 17 tetor; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike më 9 nëntor; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 13 dhjetor; Dëgjimin publik mbi zbatimin e ligjit 2002/2 për arsimimin fillor dhe të mesëm. Dëgjimin publik të projektligjit për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë.

³ Përveç nëse është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër në këtë raport, kjo është shifra e njoftuar nga Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi në fillim të ditës.

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për noterinë (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për punën (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe katër vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit të punës së Agjensisë Rregullatore të Telekomunikacionit për vitin 2005 (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Raporti i punës së Agjensisë Rregullatore të Telekomunikacionit për vitin 2005”.)
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij (Kjo pikë është shtyrë. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Emërimi i Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij”.)
- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësinë (Znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) kryesuese e komisionit, e paraqiti raportin që u pasua me debat plenar dhe miratimin e rekomandimeve të komisionit. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Monitorimi i zbatimit të ligjeve”.)
- Shqyrtimi i projekt-propozimit të Kryesisë lidhur me udhëtimet zyrtare jashtë vendit (Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 30 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 30 nëntorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 30 nëntorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2007 (Projektligji është miratuar në parim me 50 vota për dhe 26 vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 14 dhe 18 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Gjashtëdhjetë e nëntë dhe 68 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 14 përkatësisht 18 dhjetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 14 - 18 dhjetorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për memorialin e ish-Kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova (Projektligji është tërhequr nga sponzoruesi.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndihmën shtetërore (Projektligji është miratuar në parim me 45 vota për dhe 24 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje (Projektligji është miratuar në parim me 57 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për bletarinë (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Emërimi i Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij”.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për pajisjet nën presion (Projektligji është miratuar me 67 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2004/49 për patentat (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe dy vota kundër.)

- Shqyrtimi i dytë i projektligjit për sigurinë në trafikun rrugor (Shiko paragrafin e dytë të pjesa “Procesi i votimit”.)
- Shqyrtimi i projekt-planit hapësinor të Kosovës 2005-2015 (Kjo pikë është shtyrë.)
- Diskutimi i raportit të Komisionit Evropian për Kosovën (Kjo pikë është shtyrë.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 20-23 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtarë i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK) dhe z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

- Nëntëdhjetë dhe 65 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 20, 21, 22 dhe 23 dhjetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 20-23 dhjetorit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2007 (Projektligji është miratuar me 65 vota për dhe shtatë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mbrojtjen e bimëve (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht gjiri (Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse (Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2002/9 për inspektoratin e punës (Projektligji është miratuar në parim me 41 vota për dhe 25 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e ligjit Nr. 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave ligjorë në bankrotim (Projektligji është miratuar në parim me 56 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit lidhur me transferimin e fondeve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Propozimi është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Debatë lidhur me shtyerjen e negociatave për zgjidhjen e statusit (Kjo pikë është shtyrë meqë anëtarët e Ekipit të Unitetit nuk ishin të pranishëm në seancë dhe kishin deklaruar se nuk ka nevojë për një debat të tillë meqë nuk kishte zhvillime të reja në procesin negociues.)
 - Debatë për gjendjen energjitike (Z. Bajrush Xhemajli (PDK) bëri deklaratë që u pasua nga Ministri i Energjisë dhe Minierave, shefat e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të Kuvendit.)

2. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 27 tetorit, z. Alush Gashi (LDK) propozoi që raporti i zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (këtu e tutje ZAP) për të gjeturat faktike në Kuvend për vitet 2004-2005 të heqet nga rendi i ditës me arsyetimin se ishte jo i plotë dhe nuk i ofronte Kuvendit asnjë rekomandim andaj duhej që paraprakisht të kompletohej dhe të shqyrtohej nga Komisioni për buxhet. Z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se grupi parlamentar i PDK-së nuk ishte për heqjen e raportit të ZAP-së nga rendi i ditës dhe e ftoi grupin parlamentar të LDK-së që “të jetë në shërbim të sundimit të ligjit dhe të luftës kundër korrupsionit”. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se Kuvendi duhet të jetë shembull i transparencës por shtoi se propozimi i z. Gashi duhet të hedhet në votim meqë raporti i ZAP-së nuk përmbante asnjë rekomandim. Znj. Teuta

Sahatqija (ORA) diskutoi se sipas rregullores së Kuvendit rendi i ditës mund të ndryshohej vetëm duke parashtruar propozim me shkrim para fillimit të seancës plenare dhe shtoi se pika e rendit të ditës në fjalë nuk mund të heqej sepse nuk ishte bërë një propozim i tillë me shkrim. Kryetari i Kuvendit propozoi një pushim të shkurtër në mënyrë që shefat e grupeve parlamentare të merren vesh për çështjen në fjalë. Por, z. Gashi insistoi që propozimi i tij të hedhej në votim duke shtuar se grupet e tjera parlamentare kanë të drejtë t'i shprehin mendimet e tyre. Andaj, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e z. Gashi për heqjen e raportit të ZAP-së nga rendi i ditës së asaj seance, që është miratuar me 48 vota për, 30 vota kundër dhe nëntë abstenime.

- Në fillim të seancës plenare të 14 dhjetorit z. Hajredin Kuçi në emër të PDK-së propozoi që shqyrtimi i parë i projektligjit për memorialin e ish-Kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova të heqej nga rendi i ditës me arsyetimin se PDK-ja ishte në favor të një ligji më gjithëpërfshirës për ish-Kryetarët se sa për ligje nga rasti në rast. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e grupit parlamentar të PDK-së i cili është refuzuar me 35 vota për, 48 vota kundër dhe gjashtë abstenime.

Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Grupi parlamentar i LDK-së dhe ai i PDK-së kanë bërë propozime gojore në pajtim me rregullën e mëparshme,⁴ e cila nuk është më në fuqi, dhe e cila lejonte që propozimet për ndryshimin e rendit të ditës të bëhen me gojë. Edhe pas ripunimit të dispozitave lidhur me caktimin e rendit të ditës në seancën plenare të 1-2 qershorit, deputetët e Kuvendit kanë vazhduar të propozojnë amendamente në rendin e ditës, me shkrim dhe me gojë. Dispozitat e reja të cilat kërkojnë që amendamentet në rendin e ditës së seancave plenare të propozohen me shkrim duhet të respektohen vazhdimisht për t'i ikur paqartësisë apo pakënaqësisë së deputetëve të Kuvendit.

Çështjet e ngutshme

- Në fillim të seancës plenare të 19 tetorit, z. Jakup Krasniqi (PDK) propozoi që Kuvendi urgjentisht të lëshonte një deklaratë për ta kundërshtuar mbajtjen e referendumit për Kushtetutën e Serbisë në territorin e Kosovës, e cila Kushtetutë në preambulën e saj e përfshinte Kosovën si pjesë të Serbisë. Të gjitha grupet e tjera parlamentare e mbështetën propozimin e z. Krasniqi. Andaj, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e z. Krasniqi i cili është miratuar me shumicë votash për, dhe i ftoi shefat e grupeve parlamentare ta hartojnë tekstin e deklaratës që formalisht do të miratohej nga Kuvendi më vonë gjatë asaj seance.⁵

Rregulla 29.1, parasheh që “Në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t'i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim.” Andaj, ishte në autoritetin e Kryetarit të Kuvendit që ta lejojë z. Krasniqin ta parashtrtojë propozimin e tij si dhe ta hedhë atë propozim në votim.

Mocionet procedurale

⁴ Rregulla e mëparshme 23.1 parashihte që “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose ... 6 deputetë e kundërshtojnë këtë.”

⁵ Për më shumë detaje shiko më poshtë “Deklarata kundër mbajtjes së referendumit për Kushtetutën e Serbisë në Kosovë”.

- Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 16 tetor e ka diskutuar një propozim të parashtruar nga shtatë deputetë të Kuvendit⁶ më 10 tetor, me të cilin propozim Kuvendi është ftuar që të organizojë referendumin për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Në propozimin e tyre deputetët kanë arsyetuar se “me këtë formë të vendosjes së qytetarëve do t’i ikej çfarëdo pakënaqësie brenda e jashtë Kosovës, vendimi të imponuar arbitrar apo të njëanshëm lidhur me Kosovën.” Kryesia e refuzoi propozimin me arsyetimin se referendumi për Kosovën nuk mund të organizohej sepse nuk kishte ligj për referendumin dhe se ishte jashtë kompetencave të Kuvendit. Më 19 tetor deputetët në fjalë i kanë dorëzuar Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese një mocion procedural ku është pretenduar se Kryesia e ka shkelur rregullën 23 sepse nuk e ka futur propozimin e tyre në rendin e ditës së seancës plenare të 19-20 tetorit. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor ka konkluduar se nuk ka pasur shkelje të rregullës 23 në atë se propozimi i deputetëve në fjalë nuk ishte futur në rendin e ditës së seancës plenare të 19-20 tetorit.

Sipas kapitullit V të Kornizës Kushtetuese ku definohej përgjegjësitë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, Kuvendi i Kosovës nuk ka autoritetin e shpalljes së referendumit. Për më tepër Korniza Kushtetuese nuk e njeh fare institucionin e referendumit. Andaj, vendimi i Kryesisë për mos ta përfshirë propozimin në fjalë për diskutim në Kuvend dhe konkluzioni i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ishin në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

- Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor ka diskutuar mocionin e parashtruar nga z. Ferid Agani më 11 shtator, ku është pretenduar se në seancën plenare të 6 shtatorit është shkelur rregulla 29.2 sepse propozimi i Grupit për Integrim për miratimin e një deklarate për rolin e Kuvendit në procesin e vendosjes së statusit nuk është hedhur në votim si *çështje urgjente*. Komisioni ka konkluduar se nuk ka pasur shkelje të rregullës 29 në atë se propozimi i Grupit për Integrim nuk është hedhur në votim gjatë seancës plenare të 6 shtatorit.

Sipas rregullës 29.2, e cila parasheh që “Propozimi i grupeve parlamentare për çështjet urgjente vendoset nga Kuvendi”, është dashur që Kuvendit t’i ipet mundësia të votojë për propozimin e grupit Për Integrim për miratimin e deklaratës në fjalë.

- Më 23 nëntor shefja e grupit parlamentar të AAK-së znj. Gjylnaze Sylja i ka parashtruar Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese një mocion procedural ku ka pretenduar se Kryesia ka shkelur rregullën 6.5 sepse nuk e ka përfshirë propozimin e grupit të saj parlamentar për miratimin e një projekt-rezolute për diasporën kosovare në rendin e ditës së seancës plenare.⁷ Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor e ka diskutuar mocionin dhe ka konkluduar se Kryesia e ka shkelur rregullën 6.5.

Rregulla 6.5 parasheh që “Kryesia siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes.” Megjithatë, Kryesia ende nuk e ka vendosur propozimin e AAK-së në rend dite të seancës plenare. Andaj, konkluzioni i Komisionit për çështje gjyqësore legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ishte në pajtim me rregullën 6.5.

Rregulla 30.8 parasheh që “Mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës dhe mocionin për shkeljen e të drejtave të deputetit, mund t’i bëjë, madje, vetëm një deputet. Ky

⁶ Z. Emrush Xhemajli (LPK), z. Ferid Agani (PD/Për Integrim), z. Gjergj Dedaj (PLK/Për Integrim), z. Xhelal Canziba (PDK), z. Emin Krasniqi (PDK), z. Xhevat Bislimi (PDK) dhe z. Mazllom Kumnova (AAK)

⁷ Më 6 korrik, grupi parlamentar i AAK-së i ka parashtruar Kryesisë kërkesën për ta përfshirë në rendin e ditës së seancës plenare propozimin për miratimin e një projekt-rezolute për diasporën kosovare. Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 26 korrik, e ka diskutuar kërkesën e AAK-së dhe ka vendosur për shtyerjen e saj për një fazë të mëvonshme për të lejuar më shumë kohë për konsultime mes grupeve parlamentare, por propozimi nuk është diskutuar që atëherë. Për më shumë detaje shiko raportin 05/2006 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesa e titulluar “Rendi i ditës”.

mocion i parashtrohet Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.” Komisioni, konkluzionet e tij lidhur me mocionet procedurale të lartpërmendura u a ka shpërndarë deputetëve vetëm me shkrim nëpër kutitë postare në vend se t’i paraqes në seancën e parë plenare pas parashtrimit të secilit mocion komisionit, siç parashihet në rregullën 30.8. Kanë kaluar tashmë disa seanca plenare dhe Komisioni ende nuk i ka paraqitur konkluzionet e tij në seancë plenare. Poashtu, edhe konkluzioni i komisionit lidhur me mocionin procedural të z. Emrush Xhemajli (LPK) të cilin ai i a kishte parashtruar komisionit më 23 qershor 2006, nuk është paraqitur asnjëherë në seancë plenare.⁸ Në raportin monitorues paraprak është përmendur rasti ku Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka paraqitur verbalisht rekomandimin e tij lidhur me një mocion procedural në seancë plenare.⁹ Andaj, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese duhet që vazhdimisht t’i përmbahet rregullës 30.8.

Deklarata kundër mbajtjes së referendumit për Kushtetutën e Serbisë në Kosovë

- Gjatë seancës plenare të 19 tetorit, z. Jakup Krasniqi e lexoi me zë tekstin e deklaratës me të cilën dënohej mbajtja e referendumit për Kushtetutën e Serbisë në Kosovë, për të cilin tekst ishin pajtuar shefat e të gjitha grupeve parlamentare. Teksti i deklaratës është si vijon “(a) Kuvendi i Kosovës këtë veprim të Serbisë e konsideron agresion kushtetues ndaj Kosovës; (b) Kuvendi i Kosovës pret nga Grupi i Kontaktit dhe BE-ja që aktin e Serbisë ta vlerësojnë si veprim të njëanshëm, i cili nuk do të ketë ndikim në statusin politik të Kosovës; (c) Referendumi i Serbisë në Kosovë është ilegal për Kosovën prandaj nuk do të ketë efekte juridike. Mbajtja e referendumit të Serbisë në Kosovë reflekton pasiguri tek qytetarët e Kosovës. I ftojmë qytetarët serbë të Kosovës të integrohen në jetën qytetare, politike, publike e institucionale; (d) Kuvendi i Kosovës është i bindur se argumenti për shtyerjen eventuale të njohjes së pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës është i pa qëndrueshëm dhe mund t’i ndërlikojë proceset demokratike në Kosovë dhe në rajon. Populli i Kosovës është Sovran dhe duhet të vendos për fatin e tij.” Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim formal deklaratën e cila është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.

Kjo ishte në pajtim me rregullën 2 e cila parasheh që deklaratat është “deklarim i përgjithshëm politik, që votohet dhe miratohet nga Kuvendi.”

Interpelanca

- Në seancën plenare të 20 tetorit, Kuvendi diskutoi mocionin për interpelancë të parashtruar nga grupi parlamentar ORA për Ministrin e shëndetësisë lidhur me gjendjen në sistemin e shëndetësisë në Kosovë. Kryetari i Kuvendit u a përkujtoi deputetëve se sipas rregullës së re 25 grupi parlamentar që ka propozuar interpelancë për debat, ka të drejtën ta hapë debatin me një deklaratë dhjetë minutëshe dhe ta mbyll atë me një deklaratë pesë minutëshe derisa ndarja e kohës gjatë debatit do ta reflektojë përfaqësimin e çdo grupi parlamentar në Kuvend. Znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) bëri deklaratën hyrëse ku e kritikoi Qeverinë për shkaktimin e krizës në sistemin shëndetësor, se nuk ka qenë në gjendje t’u ofroj shërbime shëndetësore cilësore pacientëve dhe se nuk ka menaxhuar si duhet grevën e stafit shëndetësor. Ministri i shëndetësisë Sadik Idriz raportoi mbi situatën e sistemit shëndetësor duke deklaruar se infrastruktura në institucionet shëndetësore publike është përmirësuar gjatë dy viteve të fundit, se decentralizimi i institucioneve publike shëndetësore kishte përfunduar dhe se liçensimi i institucioneve private shëndetësore tashmë kishte filluar. Ai vazhdoi duke thënë se e pranonte se ende ka vështirësi në sistemin shëndetësor, siç është mungesa e disa barërave dhe buxheti i

⁸ Shiko raportet 05/2006 dhe 06/2006 përkatësisht pjesët e titulluara “Mocionet procedurale”, të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

⁹ Në seancën plenare më 19 dhjetor 2005 z. Hydajet Hyseni (PDK) Kryesues i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka paraqitur rekomandimin e Komisionit lidhur me një mocion procedural të parashtruar nga grupi parlamentar ORA. Shiko raportin 10/2005 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

vogël që i ishte ndarë Ministrisë së Shëndetësisë, që nuk i mundësonte Ministrisë rritjen e pagave stafit mjekësor. Disa deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare bënë deklarata para se të mbyllej debati nga Znj. Mulhaxha-Kollçaku.

Kjo ishte në pajtim me rregullën e re 25.6.

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për tatimin në vlerën e shtuar u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 28 shtator. Andaj, projektligji është shpërndarë 16 ditë pune para shqyrtimit të parë në seancën plenare më 20 tetor. Projektligji për transformimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë është shpërndarë më 12 tetor; projektligji për noterinë është shpërndarë më 18 tetor; dhe projektligji për punën është shpërndarë më 19 tetor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht 23, 17 dhe 16 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 16 nëntorit. Projektligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2007 është shpërndarë më 13 nëntor. Andaj, projektligji është shpërndarë dymbëdhjetë ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të 30 nëntorit. Projektligji për memorialin e ish-Kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova është shpërndarë më 27 tetor; projektligji për ndihmën shtetërore është shpërndarë më 10 nëntor; projektligji për bletarinë është shpërndarë më 13 nëntor; dhe projektligji për ndërtimet pa leje është shpërndarë më 15 nëntor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht, 33, 23, 20 dhe 18 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 14 dhjetorit. Projektligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse është shpërndarë më 30 tetor; projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2002/9 për inspektoratin e punës është shpërndarë më 24 nëntor; dhe projektligji për ndryshimin ligjit Nr. 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim është shpërndarë më 27 nëntor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht, 38, 19 dhe 16 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 22 dhjetorit.

Kjo nuk ishte në pajtim me rregullën 35.1 e cila parasheh që shqyrtimit i parë i projektligjit të bëhet jo më herët se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes. Me përjashtim të projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2007, të gjitha projektligjet tjera gjatë periudhës raportuese janë shqyrtuar për herë të parë tri javë pune pas datës së shpërndarjes. Kuvendi ende ka vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve në pajtim me afatin e përcaktuar në rregulloren e punës, përkundër faktit se ka filluar të mbajë seanca plenare më të shpeshta.

Procesi legjislativ

- Projektligji për auditimin e brendshëm është miratuar gjashtë muaj pas shqyrtimit të tij të parë më 17 prill. Projektligji për pajisjet nën presion dhe projektligji për ndryshimin e ligjit Nr. 2004/49 për patentat janë miratuar më shumë se dy muaj pas shqyrtimit të tyre më 9 tetor. Projektligji për sigurinë në trafikun rrugor është radhitur për miratim tetë muaj pas shqyrtimit të parë, më 16 mars. Projektligji për promovimin dhe nxitjen e të ushqyerit me qumësht gjiri është miratuar më shumë se gjashtë muaj pas shqyrtimit të parë më 1 qershor. Projektligji për mbrojtjen e bimëve është miratuar më shumë se tre muaj pas shqyrtimit të parë, më 31 gusht. Projektligji për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2007 është miratuar më pak se një muaj pas shqyrtimit të parë më 30 nëntor. *Rregulla 35.6 parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi”. Komisionet e Kuvendit i kanë paraqitur rekomandimet e tyre në shumicën e projektligjeve të lartpërmendura me një vonesë të konsiderueshme nga afati i përcaktuar me rregullën 35.6, pa kërkuar nga Kuvendi shtyerjen e afatit. Komisionet e Kuvendit duhet ta shpejtojnë shqyrtimin e projektligjeve për t’ju përmbajtur afatit të përcaktuar në rregullën e lartëshënuar. Vonesat në shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve theksojnë nevojën për planifikim më të mirë të planit legjislativ në mes të Kuvendit dhe Qeverisë.*

Procesi i votimit

- Më 27 tetor, më 17 nëntor, më 18 dhjetor dhe më 20 dhjetor, deputetët nga radhët e partive opozitare e kanë lëshuar sallën plenare duke e lënë seancën plenare pa kuorum. Në secilin rast Kryetari i Kuvendit ka përfunduar mbledhjet plenare për mungesë kuorumi. Kuorum ka pasur për të gjitha votimet në seancat plenare që janë nën shqyrtim.

Kjo ishte në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe me rregullën 31.1, të cilat parashohin që për marrjen e vendimeve shumica e deputetëve të Kuvendit duhet të jetë e pranishme.

- Më 18 dhjetor gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për sigurinë në trafikun rrugor, z. Ibush Jonuzi, kryesues i komisionit funksional (komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion), sqaroi se ishin propozuar 242 amendamente në ligjin në shqyrtim, të cilat ishin ndarë në katër grupe nga komisioni funksional: (I) 182 amendamente të propozuara nga komisioni funksional, (II) 49 amendamente të propozuara bashkarisht nga komisioni funksional dhe komisioni për buxhet, (III) 10 amendamente të propozuara nga Ramadan Kelmendi (LDK) dhe (IV) amendamenti i fundit nr. 242, që përfshinte 116 nën-amandamente të natyrës teknike. Ai më tutje propozoi që Kuvendi të votoj *en bloc* për secilin grup të amandamenteve për të kursyer kohë. Ministri i transportit dhe telekomunikacionit Qemajl Ahmeti deklaroi se pajtohej me amendamentet e propozuara nga komisionet meqë ato nuk e ndryshonin përmbajtjen e projektligjit në fjalë. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se grupi i tij parlamentar i mbështeste dy grupet e para të amandamenteve. Znj. Gjylnaze Syla deklaroi se grupi parlamentar i AAK-së i mbështeste të dy grupet e para të amandamenteve poashtu, dhe propozoi që ato të votohen *en bloc*. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) deklaroi se grupi i saj parlamentar nuk e mbështet votimin *en bloc* të amandamenteve dhe propozoi që amendamentet të votohen veç e veç. Z. Hydajet Hyseni (PDK) poashtu deklaroi se ai nuk pajtohej me propozimin për votimin *en bloc* të amandamenteve, me arsyetimin se kjo do të ndryshonte metodologjinë e shqyrtimit të projektligjeve në shqyrtim të dytë. Znj. Nekibe Kelmendi (LDK) deklaroi se rregullorja e punës nuk e ndalon votimin *en bloc* të amandamenteve dhe se Kuvendi me votë formale duhet të vendosë vetëm se a të votohet *en bloc*. Z. Ramadan Kelmendi (LDK) deklaroi se dy grupet e para të amandamenteve mund të votohen *en bloc* por, propozoi që amendamentet e tij të votohen veç e veç dhe shtoi se dëshironte t'i arsyetojë ato. Z. Nazim Jashari (ORA) diskutoi se amendamentet nuk mund të votohen *en bloc* pasi që ato ndryshojnë rrënjësisht njëri nga tjetri. Në emër të grupit parlamentar të PDK-së z. Jakup Krasniqi propozoi që projektligji ose t'i kthehej sponzoruesit ose amendamentet të votohen veç e veç. Kryetari i Kuvendit vazhdoi duke e hedhur në votim propozimin për votim *en bloc* për dy grupet e para të amandamenteve, që u miratua me shumicën e votave. Grupi parlamentar i PDK-së e lëshoi seancën plenare më pas, duke e lënë atë pa kuorum. Në mungesë të kuorumit Kryetari i Kuvendit e mbylli seancën plenare dhe shqyrtimi i dytë i projektligjit në fjalë u shty.

Rregulla 37.2 parasheh që “Amendamentet shqyrtohen veç e veç sipas radhës që paraqiten në tekstin e projektligjit, përveç nëse ndonjë grup i amendamenteve ka ndikim veprues në nenet e tjera. Në këtë rast ata mund të shqyrtohen aty ku paraqiten së pari në tekst dhe mund t'i nënshtrohen një votimi të vetëm. Kryetari i Kuvendit vendos kur gjen zbatim kjo. Komisioni funksional, gjithashtu, përcakton radhën sipas së cilës do të shqyrtohen amendamentet sipas natyrës përmbajtësore të tyre kur paraqiten në të njëjtin vend në tekst.” Arsyetimi që është dhënë në shqyrtimin e dytë të projektligjit në fjalë, nuk ka qenë se amendamentet kanë ndikim në njëri-tjetrin por se votimi për secilin amendament veç e veç për një numër kaq të madh të amandamenteve do të merrte shumë kohë.

Rregulla 61 parasheh që “Për shmangiet nga Rregullorja e punës mund të vendos Kuvendi me dy të tretat e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend, përveç nëse kjo është në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese.” Vendimi për të votuar për amendamentet en bloc nuk do të shkelte asnjë dispozitë të Kornizës Kushtetuese. Andaj, Kuvendi ka mundur të marrë vendim për t'ju shmangur përkohësisht rregullës 37.2 me kusht që propozimi të mbështetet nga dy të tretat e deputetëve të pranishëm, siç parashihet në rregullën 61.

Neni 9.1.36 i Kornizës Kushtetuese dhe rregulla 37.1 parashohin që “gjatë shqyrtimit të dytë, Kuvendi merr në konsideratë projektligjin së bashku me ndryshimet e propozuara nga komisioni(et), ose nga individë apo grupe të deputetëve të Kuvendit a të Qeverisë. Propozuesit të amendamenteve i jepet e drejta që ta arsyetojë propozimin e vet me kërkesë të tij.” Andaj, z. Ramadan Kelmendi ka pasur të drejtë të kërkojë që amandamentet e tij të votohen veç e veç dhe t’i arsyetojë ato.

Monitorimi i zbatimit të ligjeve

- Më 11 tetor, komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale i ka paraqitur Kryesisë raportin mbi monitorimin e zbatimit të ligjit për shëndetësinë dhe ka kërkuar që ky raport të futet për debat në rendin e ditës të seancës plenare të radhës.

Në mbledhjen e Kryesisë më 16 tetor, ku është diskutuar për raportin i komisionit, z. Sabri Hamiti (LDK) deklaroi se komisioni duhet ta diskutojë raportin me Ministrin e Shëndetësisë në njërën nga takimet e tij dhe shtoi se nuk ka nevojë që ky raport të diskutohet në seancë plenare. Z. Mahir Yağcilar (6+/KDTP) poashtu deklaroi se nuk ka nevojë të diskutohet raporti në seancë plenare dhe se do të mjaftonte që raporti t’u shpërndahej deputetëve. Z. Xhavit Haliti (PDK) deklaroi se nuk ka arsye që raporti të debatohet në seancë plenare dhe diskutoi se Kuvendi nuk duhet të debatojë për punën e njërit prej trupave të tij. Kryesia i ktheu raportin komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale.

Gjatë vazhdimit të seancës plenare të 20 tetorit, të filluar më 19 tetor, z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se grupi i tij parlamentar e mirëpret raportin e monitorimit të zbatimit të ligjit për shëndetësinë të paraqitur nga komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale dhe insistoi që raporti t’u shpërndahej të gjithë deputetëve dhe të debatohet në seancë plenare. Kryesuesi, z. Xhavit Haliti (PDK) deklaroi se Kryesia beson se “nuk është në rregull të zhvillojmë debat vetë me vete bazuar në raportin e komisionit tonë, por debati duhet të bëhet në raport me Qeverinë.” Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor, vendosi që raportin në fjalë ta përfshijë në rendin e ditës së seancës plenare të radhës të paraparë për datën 16 nëntor.

Më 20 nëntor, gjatë vazhdimit të seancës plenare të filluar më 16 nëntor, Kuvendi diskutoi raportin mbi monitorimin e zbatimit të ligjit për shëndetësinë dhe me shumicë votash miratoi rekomandimet e komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale.

Rregulla 53.1 parashihet që “Çdo komision brenda fushës së tij të përgjegjësive ka autoritet për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit nga Qeveria e Kosovës ose nga ministria përkatëse.” Rregulla 53.3 qartëson më tej se “Për ta ushtruar autoritetin e dhënë më lart, komisionet: (a) propozojnë masa për raste konkrete, mes tjerash dhe (ç) raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në seancat plenare të Kuvendit.” Ky ishte raporti i parë mbi monitorimin e zbatimit të një ligji, i përgatitur nga komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, gjatë vitit 2006. Asnjëri nga komisionet tjera të Kuvendit nuk ka raportuar gjatë vitit 2006 për zbatimin e ligjeve që janë në fushën e autoritetit të tyre.

Vendimi i Kryesisë i 16 tetorit për t’i mohuar Komisionit të drejtën për raportim gojor në Kuvend lidhur me raportin e monitorimit të zbatimit të ligjit për shëndetësinë, nuk është në pajtim me rregullën 53.1. Diskutimi i mëvonshëm i raportit dhe miratimi i rekomandimeve të komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale më 20 nëntor ishte në pajtim me rregullën 53.1.

Formimi i Komisionit hetimor ad hoc

- Pas heqjes së raportit të zyres së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) mbi të gjeturat faktike në Kuvend për vitet 2004 – 2005 nga rendi i ditës së seancës plenare të datës 27 tetor me kërkesë të grupit parlamentar të LDK-së, grupet parlamentare të PDK-së dhe ORA-s e lëshuan sallën plenare në shenjë proteste duke e lënë seancën plenare pa kuorum. Meqë grupet parlamentare të PDK-së dhe ORA-s refuzuan të marrin pjesë në punimet e Kuvendit përveç nëse raporti i ZAP-së futej për diskutim në njërën prej seancave plenare, Kryesia u mbledh më 2 nëntor dhe vendosi që seanca plenare e 27 tetorit të vazhdojë me të njëjtin rend dite më 3 nëntor.

Në fillim të seancës plenare më 3 nëntor Kryetari i Kuvendit lajmëroi se Kryesia një ditë më parë ishte pajtuar që për formimin e komisionit hetimor *ad hoc* të votohet pas përfundimit të debatit mbi raportin e ZAP-së. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se komisioni për buxhet apo ndonjë organ i veçantë i formuar nga Kuvendi mund t'i verifikojë të gjeturat e raportit të ZAP-së dhe shtoi se LDK-ja është e përkushtuar që të mos ndërhyj në hetimet që po kryhen nga organet gjyqësore. Z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se grupi i tij parlamentar ka kërkuar dy vite më parë formimin e një komisioni hetimor *ad hoc*, për të shikuar keqmenagjimin e fondeve publike nëpër institucione, por se ajo kërkesë ishte mbivotuar nga koalicioni qeveritar dhe shtoi se një qeverisje e tillë vështirë se mund të garantojë zhvillim ekonomik apo mirëqenie sociale për qytetarët. Ai në vijim deklaroi poashtu se raporti i ZAP-së ka konstatuar keqpërdorimin e fondeve publike në Kuvend dhe propozoi përsëri që të formohet një komision hetimor *ad hoc* nga Kuvendi për të verifikuar të gjeturat e ZAP-së. Z. Naim Maloku (AAK) deklaroi se raporti i ZAP-së ka treguar se në disa raste buxheti i Kuvendit është përdorur për qëllime personale dhe se AAK-ja i dënon këto raste. Ai shtoi se grupi i tij parlamentar është i përkushtuar për një qeverisje të mirë dhe për një menagjim efektiv të fondeve publike dhe se do të mbështesë çfarëdo nisme që do t'i kontribonte funksionimit më të mirë të Kuvendit. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) propozoi që Kuvendi të formojë një komision hetimor *ad hoc* për të hetuar të gjitha rastet e keqmenagjimit financiar dhe të rekomandojë procedurat për parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen, t'i dorëzohet raporti i ZAP-së prokurorit publik, të kërkohet auditimi i Kuvendit prej vitit 2002 deri në vitin 2005 dhe që fondet e Kuvendit të përdorura për qëllime personale t'i kthehen buxhetit të Kuvendit. Z. Numan Baliq (Për Integrim) poashtu propozoi formimin e një komisioni hetimor *ad hoc* për të verifikuar të gjeturat e ZAP-së. Pas deklarimeve në emër të grupeve parlamentare dhe pasi që të gjithë deputetët që donin të flisnin e kishin bërë këtë, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim formimin e komisionit hetimor *ad hoc* për verifikimin të gjeturave faktike të ZAP-së mandati i të cilit do të përfundonte më 31 dhjetor 2006, që u miratua me shumicë votash për. Kryetari i Kuvendit më pas thirri një pauzë të shkurtër në mënyrë që shefat e grupeve parlamentare t'i propozojnë anëtarët e tyre për komisionin hetimor. Pas pauzës, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se shefat e grupeve parlamentare janë pajtuar për përbërjen e më poshtme të komisionit: Z. Ferid Agani (Për Integrim/PD) Kryesues i komisionit, z. Lutfi Zharku (LDK) zëvendës kryesues i parë i komisionit, z. Husnija Bešković (6+/Vakat) zëvendës kryesues i dytë, z. Naser Osmani (LDK), z. Ali Sadria (LDK), znj. Besa Gaxherri (LDK), z. Shaban Halimi (LDK), z. Nimon Alimusaj (LDK), z. Gazmend Muhaxheri (ORA), z. Mazllom Kumnova (AAK), z. Gani Koci (PDK), z. Afrim Arzuallxhiu (PDK), znj. Safete Hadërgjonaj (PDK) dhe një anëtar nga SLKM-ja¹⁰ dhe e hedhi në votim formal përbërjen e komisionit hetimor, që është miratuar me shumicë votash për.

Komisioni hetimor ad hoc është formuar në pajtim me rregullën 50 e cila parasheh që "Kuvendi mund ta formojë një komision ad hoc . . . për të bërë hetime për një çështje të veçantë. Nëse Kuvendi merr vendim për themelimin e komisionit ad hoc, në vendim duhet të përfshihet përbërja, procedura dhe kohëzgjatja e komisionit ad hoc."

Raporti i punës i Agjencionit rregulativ të telekomunikacionit për vitin 2005

- Më 17 nëntor 2006, në vazhdimin e seancës plenare të filluar më 16 nëntor, Kuvendi debatoi për raportin e punës të Agjencionit Rregullativ të Telekomunikacionit (ART) për vitin 2005. Në fillim të debatit z. Anton Berisha Drejtor i ART-së e paraqiti raportin në Kuvend, i pasuar nga z. Ibush Jonuzi, kryesues i komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion (komisioni funksional) i cili i bëri disa rekomandime për punën e ART-së. Z. Alush Gashi, deklaroi se grupi i tij parlamentar e mirëpret raportin e ART-së dhe i bëri thirrje Qeverisë që ta mbështes ART-në në kryerjen e detyrave të saj në mënyrë të efektshme. Në deklaratën e tij z. Jakup Krasniqi (PDK) e kritikoi ART-në për paaftësinë e ofrimit të shërbimeve cilësore qytetarëve dhe për mos parandalimin e veprimtari të operatorëve mobil ilegal në Kosovë. Ai më tutje propozoi që Kuvendi ta shkarkoj bordin e ART-së. Znj. Gjylnaze Sylja

¹⁰ Znj. Snežana Milić është propozuar më vonë nga SLKM-ja që të jetë anëtare e komisionit hetues.

(AAK) deklaroi se grupi palamentar i saj e mbështet ART-në si dhe rekomandimet e komisionit funksional. Z. Genc Gorani (ORA) e inkurajoi ART-në që të intensifikoj punën e tij kundër operatorëve ilegal mobil dhe propozoi që ART-ja të raportoj më shpesh para komisionit funksional. Z. Gani Koci (PDK) propozoi që Kuvendi të votoj për shkarkimin e bordit të ART-së. Z. Sabri Hamiti (LDK) kundërshtoi duke thënë se ligji për telekomunikacionin parashikon procedurë tjetër për largimin e zyrtarëve të ART-së, sipas të cilit Ministri i transportit dhe telekomunikacionit është ai i cili i rekomadon largimin e anëtarëve të bordit të ART-së Qeverisë ku kjo e fundit pastaj i bën një propozim të tillë Kuvendit për miratim. Ai shtoi se deputetët të cilët nuk janë të kënaqur me mënyrën e tillë për shkarkim, mund të marrin nismën për ndryshimin e ligjit për telekomunikacionin. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se sipas nenit 7.5-6 të ligjit për telekomunikacionin, vetë bordi i ART-së e ka autoritetin për shkarkimin e një anëtari me dy të tretat e votave të anëtarëve të bordit, e pastaj ky vendim duhet të shqyrtohet nga Kuvendi. Z. Xhavit Haliti (PDK) kundërshtoi duke thënë se Kuvendi ka të drejtë ta shkarkojë bordin e ART-së sepse Kuvendi është ai që në rend të parë e ka miratuar emërimin e anëtarëve të këtij bordi. Z. Krasniqi sërish insistoi që propozimi i PDK-së për shkarkimin e bordit të ART-së të votohet nga Kuvendi. Kryetari i Kuvendit vazhdoi duke hedhur së pari në votim rekomadimet e komisionit funksional, që u miratuan me 46 vota për dhe 15 kundër. Më pas, ai e hedhi në votim propozimin e PDK-së për shkarkimin e bordit të ART-së, i cili u hodh poshtë me 21 vota për dhe 24 kundër. Në këtë pikë, grupi parlamentar i PDK-së e lëshoi sallën plenare.

Nenet 7.5-6 të ligjit për telekomunikacionin parashohin që “Me dy të tretat e votave të anëtarëve, bordi do të largojë një anëtar në bazë të jo-kompetencës profesionale apo sjelljeve të këqija. Çdo shkarkim nga detyra në pajtim me nenin 5 do të jetë objekt i shqyrtimit dhe miratimit në Kuvend.” Megjithatë, ligji për telekomunikacionin nuk e rregullon shkarkimin e gjithë bordit të ART-së. Sipas neneve të lartëshënuara, nisma për shkarkimin madje edhe të një anëtari të vetëm të bordit të ART-së, duhet të vijë nga vetë bordi, që pastaj shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend.

Rregulla 33 e Rregullorës së punës së Kuvendit parasheh në mes tjerash që “Projektligjin mund ta paraqesë për shqyrtim në Kuvend ... një deputet i Kuvendit, i përkrahur nga pesë deputetë të tjerë që kanë nënshkruar projektligjin apo një grup parlamentar”. Grupi parlamentar i PDK-së ka të drejtë të propozojë amandamente në ligjin për telekomunikacionin, për t’i adresuar çështjet e ngritura më lart.

Emërimi i Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij

- Më 16 shkurt 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) e ka shpallur Rregulloren 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të popullit, ku i ka dhënë Kuvendit të Kosovës autoritetin për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij si dhe të tre zëvendësve të tjerë. Pas miratimit të rregullores në fjalë, komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese i Kuvendit të Kosovës e ka hartuar rregulloren për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij, që është miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të 15 qershorit 2006. Pas miratimit të rregullores për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij, komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka formuar panelin rekrutues¹¹ për të procesuar aplikacionet dhe për t’i rekomanduar kandidatët e zgjedhur për Avokat të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij për përzgjedhje nga Kuvendi.

Më 17 nëntor, në vazhdimin e seancës plenare të filluar më 16 nëntor, z. Sadudin Berisha, zëvendës kryesuesi i parë i komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese raportoi mbi procedurat dhe punën e panelit të rekrutimit lidhur me emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij. Z. Berisha deklaroi më tutje se paneli njëzëri ka propozuar këta kandidatë për Avokat të popullit - z. Hilmi Jashari, z. Ibrahim Makolli dhe

¹¹ Anëtarët e panelit ishin: Znj. Nekibe Kelmendi (Kryesuese/LDK), znj. Nerxhivane Dauti (PDK), znj. Gjylnaze Sylja (AAK), z. Nazim Jashari (ORA), z. Dragiša Krstović (SLKM), z. Husnija Bešković (6+) dhe z. Numan Balić (Për Integritim).

znj. Diana Toska, dhe për postin e zëvendësit kryesor - z. Palë Bala, z. Ljubinko Todorović dhe z. Habit Hajredini. Ai vazhdoi duke thënë se votimi duhet të jetë i fshehtë dhe nëse asnjëri nga të propozuarit nuk e merr shumicën absolute të votave (së paku 61 vota për) në cilindo nga të dy raundet, atëherë konkursi duhet të rishpallet. Znj. Zlatica Kujundjić (Partia Demokratike Serbe/SDS) kërkoi nga Kuvendi që të shtyhet votimi për emërimin e zëvendësit kryesor të Avokatit të popullit për seancën e radhës për t'i lejuar partisë së saj më tepër kohë për konsultime. Sidoqoftë, shefat e grupeve parlamentare të LDK-së, AAK-së, ORA-s, 6+ dhe Për Integrim propozuan që të dy emërimet të shtyhen për seancën plenare të radhës meqë grupi parlamentar i PDK-së nuk ishte i pranishëm në seancë. Andaj, Kuvendi e shtyri këtë pikë të rendit të ditës për seancën e radhës.

Në seancën plenare të 14 dhjetorit, z. Berisha i paraqiti sërish propozimet dhe rekomandimet e panelit rekrutues dhe e sqaroi procedurën për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij. Kuvendi më pas vazhdoi me votimin e fshehtë, në përputhje me procedurën. Në raundin e parë të votimit rezultati i votimit për Avokatin e popullit ishte si në vijim: z. Hilmi Jashari – 6 vota, z. Ibrahim Makolli – 41 vota dhe znj. Diana Toska – 30 vota, ndërsa dy fletëvotime u shpallën të “pavlefshme”, sipas të gjitha gjasave ishin abstenime. Rezultati i votimit për zëvendësin kryesor të Avokatit të popullit ishte si në vijim: z. Palë Bala – 27 vota, z. Habit Hajredini – 17 vota dhe z. Ljubinko Todorović - 26 vota. Pas shpalljes së rezultatit të raundit të parë të votimit, kryesuesi i dha fjalën z. Berisha për shpjeguar procedurën e mëtutjeshme. Z. Berisha sqaroi se meqë asnjëri prej të propozuarve nuk ka marrë shumicën absolute të votave në raundin e parë, Kuvendi duhet të vazhdoj me raundin e dytë me nga dy të propozuar për secilin post, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave. Në raundin e dytë të votimit rezultati i votimit për Avokatin e popullit ishte si në vijim: z. Ibrahim Makolli – 41 vota dhe znj. Diana Toska – 34 vota, ndërsa tri fletëvotime u shpallën të “pavlefshme”. Rezultati i votimit për zëvendësin kryesor të Avokatit të popullit ishte si në vijim: z. Palë Bala – 37 vota dhe z. Ljubinko Todorović – 32 vota, ndërsa nëntë fletëvotime u shpallën të “pavlefshme”.

Pas shpalljes së rezultateve të raundit të dytë të votimit, disa nga deputetët e Kuvendit theksuan se ka një mospërputhje ndërmjet Rregullores 2006/6 të UNMIK-ut dhe rregullores së miratuar nga Kuvendi për sa i përket numrit të votave që kërkohen në mënyrë që emërimet të jenë të vlefshme. Z. Berisha sqaroi se neni 6.2 i Rregullores 2006/6 të UNMIK-ut parasheh që Avokati i popullit dhe zëvendësi kryesor i tij të emërohen nga Kuvendi me votim me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, domethënë së paku 61 vota, por, shtoi se, rregullorja e miratuar nga Kuvendi parasheh që kandidati për Avokat të popullit, respektivisht për zëvendësin kryesor të tij, që ka marrë numrin më të madh të votave në raundin e dytë të votimit konsiderohet i emëruar. Z. Berisha më tutje deklaroi se Rregullorja e UNMIK-ut mbizotëron mbi rregulloren e miratuar nga Kuvendi andaj shtoi se emërimet nuk mund të konsiderohen të vlefshme. Z. Hydajet Hyseni (PDK), Kryetar i komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, deklaroi se sipas parimit ligjor – akti i ri ligjor shfuqizon aktin e vjetër - rregullorja e miratuar nga Kuvendi mbizotëron Rregulloren e UNMIK-ut meqë rregullorja e Kuvendit është miratuar më vonë, andaj, shtoi se Avokati i popullit dhe zëvendësi kryesor i tij duhet të konsiderohen të emëruar. Në emër të grupit parlamentar të LDK-së, z. Alush Gashi (LDK), propozoi që Kryesia ta sqarojë këtë mospërputhje, me Zyrën Ligjore të UNMIK-ut dhe ta informoj Kuvendin në përputhje me rrethanat. Kryesuesi më pas e hedhi në votim propozimin e z. Gashi, i cili u miratua me shumicë votash për.¹²

Neni 6.2 i Rregullores 2006/6 për Institucionin e Avokatit të popullit parasheh që Avokatin e popullit dhe zëvendësin kryesor të tij i emëron Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente të votimit me përkrahjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që nënkupton mbështetjen e së paku 61 deputetëve të Kuvendit. Në anën tjetër sipas rregullores për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij të miratuar nga Kuvendi, Avokati i popullit dhe zëvendësi kryesor i tij emërohen me shumicën e thjeshtë të

¹² PSSP-ja i ka dërguar interpretimin ligjor Kryesisë pas periudhës raportuese, andaj kjo çështje do të mbulohet në raportin e radhës.

deputetëve të Kuvendit. Parimi ligjor - lex posterior derogat lex anterior – (akti i ri ligjor shfuqizon aktin e vjetër) - i cili rregullon hierarkinë e akteve ligjore, vlen vetëm për aktet me fuqi të njëjtë ligjore. Në këtë rast, rregullorja e miratuar nga Kuvendi është akt nënligjor meqë buron nga Rregullorja 2006/6. Andaj, për këtë arsye, Rregullorja e UNMIK-ut ka përparësi mbi rregulloren në pyetje. Si përfundim, votimi në seancën plenare të 14 dhjetorit për emërimin e Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm meqë asnjëri prej të propozuarve nuk ka marrë mbështetjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit siç parashihet në dispozitën e lartëshënuar.

Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore

- Në seancën plenare të 19-20 tetorit, katër nga pesë pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 27 tetorit, të gjitha pyetjet ishin shtyrë për seancën e radhës për shkak të mungesës së kuorumit. Në seancën plenare të 16/17/20 nëntorit, pesë nga gjashtë pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 30 nëntorit, tri nga pesë pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 14/18 dhjetorit, dy nga katër pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 20-23 dhjetorit, një nga tri pyetje mori përgjigje. Kryetari i Kuvendit u përgjigj duke thënë se pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit. Në seancat plenare të 19-20 tetorit dhe 30 nëntorit z. Hydajet Hyseni (PDK) e ka ngritur përsëri çështjen e një pyetje të cilën e kishte parashtruar për Ministrin e Qeverisjes Lokale para shumë kohësh, dhe që nuk kishte marrë ende përgjigje, dhe insistoi që të merrte përgjigje. Në seancën plenare të 30 nëntorit, Ministri për Qeverisje Lokale Lutfi Haziri më në fund i është përgjigjur pyetjes së z. Hyseni.

Koha për pyetjet parlamentare është bërë nga Kuvendi në pajtim me rregullën e re 26 për “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare të përfshijë edhe kohën prej 50 minutash për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e Ministrisë, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta përgjigja në pyetjen shtesë.

Z. Hyseni së pari e kishte dorëzuar pyetjen e tij më 8 gusht 2005, kur rregulla e mëparshme 26 për pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë ishte në fuqi. Më 13 qershor, pas ndryshimit të rregullës 26 në seancën plenare të 1-2 qershorit 2006, z. Hyseni e ka ri parashtruar pyetjen e tij por nuk ka marrë përgjigje deri në seancën plenare të 30 nëntorit. Sipas rregullës së re 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletinin e Kuvendit.” Buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pjesë me pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë, prandaj asnjëra nga pyetjet për Qeverinë që presin përgjigje nuk është publikuar ndonjëherë. Publikimi i pyetjeve të deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje në buletin e Kuvendit të Kosovës do ta rriste përgjegjësinë e Qeverisë ndaj Kuvendit.¹³

3. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Më 4 dhjetor 2006, z. Bislim Hoti (IRDK/Egjiptian) i ka dërguar një letër Kryesisë ku e ka informuar atë se ai do të shërbente në Kryesi nga 1 janari 2007, në pajtim me marrëveshjen e arritur mes IRDK-së, KDTP-së dhe Vakati-it në dhjetor të 2004 lidhur me përfaqësimin e komuniteteve joserbe dhe joshqiptare në Kryesi.¹⁴ Në takimin e Kryesisë të mbajtur më 11 dhjetor ku është diskutuar letra e z. Hoti, z. Ramë Buja (PDK) ka deklaruar se z. Hoti nuk mund të jetë anëtar i Kryesisë meqë ai është anëtar i grupit parlamentar të AAK-së. Z. Sabri Hamiti (LDK) arsyetoi se meqë z. Hoti nuk ishte anëtar i grupit 6+, ai nuk mund të bëhej anëtar i

¹³ Shiko pjesën e titulluar “Pyetjet për Qeverinë” të raporteve 03/2006, 04/2006, 05/2006 dhe 06/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

¹⁴ Më 2 dhjetor 2004, KDTP (partia turke), Vakati-i (partia boshnjake) dhe IRDK (partia egjiptiane) që përfaqësojnë tetë nga dymbëdhjetë deputetë të Kuvendit nga radhët e komuniteteve joserbe dhe joshqiptare, kanë arritur marrëveshjen sipas të cilës ata do të përfaqësoheshin në Kryesi mbi bazën e një rotacioni vjetor, ku z. Džezair Murati (6+/Vakati), do të shërbente në Kryesi gjatë vitit të parë, pastaj z. Mahir Yağcilar 6+/KDTP) gjatë vitit të dytë dhe z. Bislim Hoti (IRDK) gjatë vitit të tretë. Sipas marrëveshjes, z. Murati tashmë kishte shërbyer në Kryesi gjatë vitit 2005 dhe z. Yağcilar ishte duke shërbyer nga janari i vitit 2006.

Kryesisë dhe se deputetët tjerë që nuk ishin pjesë e marrëveshjes së KDTP-së, Vakait dhe IRDK-së mund të kenë kundërshtime. Z. Gazmend Muhaxheri (ORA) kundërshtoi duke thënë se deputetët e Kuvendit që i përkasin komunitetit joserb dhe joshqiptar, kanë të drejtë për të vendosur lidhur me përfaqësimin e tyre në Kryesi. Ai arsyetoi duke thënë se marrëveshja e arritur në mes KDTP-së, Vakait dhe IRDK-së duhet të respektohet meqë ata përfaqësojnë shumicën e deputetëve nga komunitetet joserbe dhe joshqiptare, respektivisht tetë nga dymbëdhjetë deputetë. Në fund të diskutimit disa deputetë të Kryesisë deklaruan se kjo çështje duhet të qartësohet më tej.

Në fillim të seancës plenare të 14 dhjetorit, z. Xhevdet Neziraj (IRDK/egjiptian) kërkoi nga Kryetari i Kuvendit të shpjegojë se pse çështja e përfaqësimit të z. Bislim Hoti (IRDK/egjiptian) në Kuvend nuk ishte përfshirë në rendin e ditës së asaj seance plenare, dhe shtoi se sipas marrëveshjes mes Vakait, KDTP-së dhe IRDK-së të dhjetorit 2004, z. Hoti ka të drejtën për të shërbyer në Kryesi gjatë vitit të tretë të mandatit të saj. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se kjo çështje është ende në procedurë. Z. Neziri diskutoi se sipas Kornizës Kushtetuese, deputetët që i përkasin bashkësive joserbe dhe joshqiptare kanë të drejtë të vendosin për përfaqësimin e tyre në Kuvend. Z. Hajredin Kuçi (PDK) diskutoi se përfaqësimi i z. Hoti në Kryesi do të thoshte përfaqësim i dyfishtë i grupit parlamentar të AAK-së, meqë IRDK-ja ishte pjesë e këtij grupi. Z. Bujar Dugolli (AAK) kundërshtoi se sipas Kornizës Kushtetuese z. Hoti ka të drejtën e përfaqësimit në Kryesi si deputet i bashkësive joserbe dhe joshqiptare, pa marrë parasysh faktin se ai ishte anëtar i grupit parlamentar të AAK-së. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) poashtu deklaroi se bashkësitë joserbe dhe joshqiptare pa kurrfarë ndërhyrje kanë të drejtën të vendosin se kush prej tyre do t'i përfaqësojë në Kryesi. Z. Kuçi diskutoi përsëri se "Kuvendi funksionon bazuar në dy grupe – grupet parlamentare dhe komisionet, e jo në grupe etnike, fetare apo ndonjë grup tjetër". Znj. Nekibe Kelmendi (LDK) deklaroi se Kuvendi duhet ta respektojë marrëveshjen e arritur në mes të tri bashkësive më të mëdha joserbe dhe joshqiptare, e jo të ndërhyj në të. Kryetari i Kuvendit e përsëriti se çështja është ende në procedurë dhe se së shpejti do të vendoset për të.

Kryesia, në takimin e mbajtur më 18 dhjetor, e ka diskutuar përsëri çështjen e përfaqësimit të z. Hoti në Kryesi dhe ka vendosur që të kërkojë interpretim ligjor në këtë çështje nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut.¹⁵

Neni 9.1.7 (f) i Kornizës Kushtetuese parasheh që "Një anëtar i Kryesisë do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb. Metoda për emërimin e këtij anëtar i të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin komuniteteve të njëjta." Më tutje, neni 9.1.8 parasheh që "Kuvendi i miraton këto emërime me anë të një vote formale." Andaj, Kryesia nuk ka rol në miratimin apo refuzimin e marrëveshjes së arritur nga komunitetet joserbe dhe joshqiptare lidhur me përfaqësimin e tyre në Kryesi. Për më tepër, roli i Kuvendit është vetëm ta miratojë atë marrëveshje me votë formale duke mos ndërhyrë në marrëveshjen interne të komuniteteve të tjera. Z. Bislim Hoti është propozuar të shërbejë në Kryesi si përfaqësues i komunitetit egjiptian dhe jo si anëtar i grupit parlamentar të AAK-së. Andaj, anëtarësimi i tij në grup parlamentar është jorelevant në këtë rast.

Mocionet për sfidimin e ligjeve të miratuara mbi bazën e efektit të tyre në interesat jetike të komuniteteve

- Kryesia, më 25 gusht 2006 ka shqyrtuar përgjigjen e Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale në mocionin e grupit Për Integritim për sfidimin e ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, dhe ka propozuar që të formohet një panel i posaçëm për t'u marrë me këtë çështje. Megjithatë, ky panel nuk është formuar ende.¹⁶

¹⁵ PSSP-ja i ka dërguar interpretimin ligjor Kryesisë pas periudhës raportuese, andaj kjo çështje do të mbulohet në raportin e radhës.

¹⁶ Për më shumë detaje shiko raportet 05/2006 dhe 06/2006 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

Sipas nenit 9.1.41 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 40.3, “Nëse Kryesia nuk e dorëzon një propozim të tillë të bërë me konsensus brenda një periudhe pesëditore, atëherë një panel i përbërë prej tre anëtarëve, një anëtar i emëruar nga ata që mbështesin mocionin, një anëtar i emëruar nga ata që sponsorojnë ligjin ose dispozitën dhe një anëtar i emëruar nga PSSP-ja, i cili edhe drejton këtë panel, e merr çështjen në dorë. Ky panel brenda pesë ditësh nxjerr vendim, ku i rekomandon Kuvendit ta kundërshtojë mocionin ose . . . dispozitat në fjalë, ose ta miratojë ligjin me amendamente të propozuara nga ky panel.” Paneli i posaçëm duhet të formohet me shpejtësi për t’u marrë me mocionin e grupit Për Integrim.

4. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, dhe në mbledhjet e komisioneve. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

5. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.